

**VENDIM**  
**Nr.1167, datë 13.8.2008**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS RRETHINA TË QARKUT TË SHKODRËS, TË OBJEKTIT “TOKË BUJQËSORE” QË KA QENË NË ADMINISTRIM TË QENDRËS SË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE (QTTB), SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “b”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Objekti “Tokë bujqësore” me numër kadastral 152, numër pasurie 152/1, indeks harte K-34, 64 (177-C), me sipërfaqe 7000 (shtatë mijë) m<sup>2</sup>, kategoria II, në administrim të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, të kalojë në pronësi të komunës Rrethina, të qarkut të Shkodrës, për ndërtimin e një shkolle të mesme, në përshtatje me dispozitat e ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

2. Kjo sipërfaqe, e cila, në regjistrat kadastralë të seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, të qarkut të Shkodrës, është shënuar si “Tokë bujqësore”, të ndryshojë në zërin kadastral “Tokë urbane” (truall).

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrethina për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**